Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**14.11.2023**	**16.11.2023**	**2023/0876**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.11.2023, **OE "EBK SH.P.K."- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0876**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit **LOT 2**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-te"** me nr. të prokurimit: **"214-23-6442-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **LOT 2- 2,288,173.44 €.**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP, Qellimi
Neni 7 i LPP, Barazia ne Trajtim
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Me dt. 26.10.2023 kemi pranuar Njoftimi mbi vendimin e autorietit kontraktues mbi refuzimimin e kerkeses per rishqyrtim per proceduren qe eshte subjekt i kesaj ankese.

Ne letren standarde mbi tenderusin e eliminuar AK thekson se bashkimi i perkohshem i operatoreve ekonomik EBK SH.P.K & PRO ARK Construction shpk & N.P.N. Univers-MI nuk i ka plotesuar kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale sipas pikes 9.1 dhe 9.2, per nje inxhinier te diplomuar ose master te ndertimatarise drejtimi konstruktiv, minimumi 5 vjet pervoje pune pas diplomimit ne ndertim te larte, - deshmia Evidenca 4, per inxhinere duhet te paraqitet diploma perkatese e noterizuar nga origjinali se paku jo me e vjeter se 6 muaj nga data e publikimit te njoftimit per kontrate, CV, kontrata ose marreveshja e punes valide per kete projekt. Leter reference ose cfaredo dokumnti tjeter nga punedhenesi qe deshmon per punet dhe pervojen e meparme ne lemin e kerkuar. AK thekson se BPOE ka paraqitur inxhinierin me iniciale BJ. mirepo te kerkesa: kontrata ose marreveshja e punes valide per kete projekt ju kei prezentuar nje kontrate pune ne mes te anetarit te konzorciumit EBK SHPK dhe inxhinierit B.J. Kjo kontrate eshte per nje projekt tjeter (institucion tjeter). Ne kemi sqaruar ne Kerkesen per Rsihqyrtim se " Inxhinieri Bardhok Jetshi eshte pronar i kompanise N.P.N UNIVERS - MI, dhe me kompanine e vet ka kontrate te perhersheme te punesimit, Sikur edhe po e bashkelidhim ketu me poshte. I njejti figuron ne listepagesat e NPN UNIVERS - MI. Kontrata mes EBK dhe inxhinieri Bardhok Jetishi eshte ngarkuar gabimisht, si gabim teknik, dhe AK mund te shfrytezoje nenin 72 te LPP, per sqarime shtese, permes te cilave do te idhim sqaruar se inxhinieri ne fjale eshte ne dispozicion te plote pergjate te gjithe periudhes se zbatimit te kesaj kontrate. Me kerkese te AK inxhinieri mundet ne prezence fizike, apo permes deklarates te deshmoj se eshte ne dispozicion per realizimin e kesaj kontrate.Ne, mbesim prane pretendimit tone ne kerkesen per rishqyrtim. " Autoriteti Kontraktues kete kerkese tone e ka cilesuar si te bazuar.

Përgjigje në pretendimet Ankimore 1

1. Autoriteti kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme–ZPP pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore lidhur me inxhinierin Bardhok Jetishi duke u bazuar edhe ne dëshmitë e dorëzuara ne kërkesën per rishqyrtim me te cilën është dorëzuar dëshmi kontrata e punës se inxhinierit Bardhok Jetishi dhe se i njëjti është pronar i kompanisë e cila kompani është pjese e konsorciumit ne ofertën e dorëzuar, konstatojmë se ky pretendim është i bazuar.

Ne piken e dyte:

Kerkesa 2, Nje teknik i certifikuar per BMS - deshmia certifikata perkatese e noterizuar nga origjinali se paku jo me vjeter se 6 muaj, CV, kontrata ose marreveshja e punes valide per kete projekt. Leter reference nga punedhenesi ose cfaredo dokumenti tjeter qe dheshmon per punet dhe pervojen e

meparshem ne lemin e kerkuar. AK thekson se BPOE, per teknikun per BMS me iniciale V.G. nuk ka prezentuar marreveshje valide te punes per kete projekt. AK thekson se kontrata nuk eshte valide sepse eshte nenshkruar nga nje pale e trete ne emer te teknikut. Ne lidhje me kete pretendim te AK ne e kemi sqaruar ne Kekreksen per Rishqyrtim si vijon "ne periudhen kur eshte dorezuar tenderi, tekniku V.G. ka qene ne udhetim jashte shtetit, ne Gjermani, dhe me autorizim nga vet tekniku, eshte nenshkruar kontrata. Nese tekniku nuk ka qene fizikisht, dhe nese nenshkrimi do te ishte bere ne emer te V.G. atehere ne do te kryenim veper penale te falsifikimit te dokumentit, andaj, ne duke pasur konfirmimin verbal nga V.G. se do te jete ne dipozicion per kete kontrate, dhe me lejen e tij, kemi nenshkruar ne emer te V.G. AK duke aplikuar nenin 72 te LPP mund te kerkoje sqarime, dhe tekniku V.G. eshte i gatshem qofte me prezence fizike, qofte me deklarate te shkruar te konfirmoj se do te jete ne dispozicion te plote per realizimin e puneve te BMS per kete kontrate. Ne zotohemi se inxhinieri B.J. dhe tekniku i BMS V.G. jane ne dijeni te plote te kushteve te kontrates, dhe jane ne pajtim te plote per angazhimin e tyre ne kete procedure prokurimi."

Autoriteti kontraktues kete pike serish e cileson si te pabazuar me arsyetimin si me poshte:

Përgjigje në pretendimet Ankimore 2
Një Teknik i certifikuar për BMS -
2. Dëshmia:
Certifikata përkatëse të noterizuar nga origjinali së paku jo me të vjetër se 6 muaj, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar .

Ju për këtë kërkesë ne ofertën tuaj keni prezantuar teknik për BMS me iniciale V.G. mirëpo te kërkesa ne dosjen e tenderit është kërkuar , kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt.
Ju keni prezantuar një kontratë pune ne mes te anëtarit te konzerciumit EBK SH.P.K dhe inxhinierit V.G, te pjesa e nënshkrimit shihet se nuk është e nënshkruar nga vet tekniku i BMS por është nënshkruar (Për) nga një palë e tret dhe si rrjedhoje kontrata është jo valide për shkak së e njëjta nuk është e nënshkruar nga punëmarrësi, dhe nuk keni dozuar dëshmi-Autorizim këtë e keni konfirmuame edhe vet në këtë pretendim që personi nënshkrues i këtij dokumenti nuk kas pasur autorizim me shkrim. Dhe mbi këtë bazë ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm dhe **refuzohet i pa bazuar.**

Ak bën shkelje te LPP duke mos aplikuar nenet Neni 1 i LPP, Qellimi, Neni 7 i LPP, Barazia ne Trajtim, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale dhe Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, duke mos kerkuar sqarime shtese e as vetedeklarim nga ana e teknikut V.G. i cili eshte i gatshem qofte me prezence fizike, qofte me deklarate te shkruar te konfirmoj se do te jete ne dispocion te plote per realizimin e puneve te BMS per kete kontrate.

Te bashkelidhur po ju dergojme deklaraten e Z, Vegim Gashi te nenshkruar nga vete Z, Vegim Gashi, i cili eshte i gatshem edhe me prezence fizike te deshmoje te njejten, ose nese kerkohet nga ju edhe me deklarate noteriale.

Prishtinë, 03 Nëntor 2023

DEKLARATË

Unë Vegim Gashi, i lindur me datë 11.09.1963, bartës i letërnjoftimit me numër personal 1019560909, përmes kësaj deklarate deklaroj se:

EBK shpk me pronar Flamur Shefiku, më ka kontraktuar dhe jemi pajtuar që të angazhohem për punët profesionale në realizimin e sistemit BMS për projektin: LOT 1-VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PER VLERESIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINE - Faza 11-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza 11-të.

Për shkak se kam qenë në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës, në pamundësi fizike për të nënshkruar, skanuar dhe dërguar kontratën e angazhimit, e kam udhëzuar kompaninë EBK shpk që të nënshkruaj në emër tim.

Unë jam i njohtuar dhe jam pajtuar me përshkrimin e punëve dhe me përmbajtjen e kontratës, andaj edhe nënshkrimin e kontratës e cilësoj si të nënshkruar nga unë personalisht.

Permes kësaj, gjithashtu deklaroj se me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, unë mund të paraqitem edhe personalisht për ta vërtetuar një gjë të tillë.

Me respekt,

Vegim Gashi

me 03 nëntor 2023

Duke anuluar kete procedure te prokurimit, AK ben shkelje te Neni 1 i LPP, Qellimi, Neni 7 i LPP, Barazia ne Trajtim, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, duke mos e kualifikuar BPOE EBK SH.P.K & PRO ARK Construction shpk & N.P.N. Univers-MI, demton buxhetin e Republikes se Kosove, vonon realizimin e projetit panevoje.

Duke pase parasysh se nevoja e AK eshte per te realizuar ne menyre sa me profesionale kete objekt, dhe se nuk eshte ne interes publik zhagitja e fililimit te puneve ne realizimin e ketij projekti, ne si Bashkim i Perkoheshme Ekonomik, zotohemi qe do te zbatojme komplet kontraten ne perputhshmeri me specifikimet teknike dhe standardet e aplikueshme ne Republiken e Kosoves, dhe nuk kemi asnje mungese ne kapacitete teknike dhe profesionale per realizimin mbrenda afateve kohore te kesaj kontrate, ne perputhshmeri me kerkesat e AK.

Kërkojmë nga OSHP që të APROVOJ ankesen tonë si të qëndrueshme dhe ta ANULON njoftimin mbi vendimin tuaj për anulimin e procdures, dhe lëndën ta ktheheni në rishqyrtim dhe pastaj, ekzaminimi,

vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet duke u bazuar në FDT dhe ne sqarimet sipas provizioneve te LPP, dhe te rivendoset ne favorte BPOE EBK SH.P.K & PRO ARK Construction shpk & N.P.N. Univers-ML.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar

Prishtinë: 19.10.2023

Adresa e Autoritetit Kontraktues: **MPB– Divizioni i Prokurimit**

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: Grup i Operatorëve Ekonomik EBK SH.P.K.; PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI,

Nr. i prokurimit	214-21-7151-5-1-1

Titulli: "LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]/* _____

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim.

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar;

Nuk keni dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2.

1. Kërkesa:
Një (1) Inxhinier të Diplomuar ose Master të Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktive - minimumi 5 vjet përvojë punë pas diplomimit në ndërtim të lartë.

1.Dëshmia:
Evidenca 4. Për inxh. duhet të paraqitet Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali së paku jo me të vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference ose çfarëdo dokumenti tjetër nga punëdhënësit që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmine e kërkuar.

Dëshmia qe NUK keni ofruar:

Ju për ketë kërkesë ne ofertën tuaj keni prezantuar inxhinierin me iniciale B.J mirëpo te kërkesa e dosjes se tenderit është kërkuar : *kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt*, ju keni prezantuar një kontratë pune ne mes te anëtarit te konzerciumit EBK SH.P.K dhe inxhinierit B.J, kjo kontrate është për një projekt tjetër (institucion tjetër)

kontrata ne fjalë nuk është kontrate e rregullte punës e po ashtu nuk është kontratë ne emër te projekti tone.

2.Kërkesa:
Një Teknik i certifikuar për BMS -

2. Dëshmia:
Certifikata përkatëse të noterizuar nga origjinali së paku jo me të vjetër së 6 muaj, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar .

Dëshmia qe NUK keni ofruar:

Ju për ketë kërkesë ne ofertën tuaj keni prezantuar teknik për BMS me iniciale V.G, mirëpo te kërkesa ne dosjen e tenderit është kërkuar , *kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt.*
Ju keni prezantuar një kontratë pune ne mes te anëtarit te konzerciumit EBK SH.P.K dhe inxhinierit V.G, te pjesa e nënshkrimit shihet se nuk është e nënshkruar nga vet tekniku i BMS por është nënshkruar (Për) nga një palë e tret dhe si rrjedhoje kontrata është jo valide për shkak se e njëjta nuk është e nënshkruar nga punëmarrësi.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar për te dy Lotët dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"

Nr. i prokurimit[2]	**214-26-6442-5-1-1**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave për Lot 1	Vlera totale e ofertave për Lot 2
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik EBK SH.P.K.; PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI,	1,748,088.00 €	2,070,800.92 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.	1,874,249.86 €	2,182,852.32 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik Astraplan SH.P.K.; U - UNIQUE SH.P.K.; INET SH.P.K.	1,777,777.77 €	2,177,777.77 €
4	Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.	1,854,576.19 €	2,168,903.73 €
5	**Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; Decon SH.P.K.**	**1,652,408.34 €**	**1,971,761.80 €**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

.**Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen** me kontratë **Grup i Operatorëve Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; Decon SH.P.K.- për Lot 1 LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të" vlera totale e ofertës 1,652,408.34 €€**

. **Ministria e Punëve të Brendshme anulon**[3] aktivitetin e prokurimit :
Lot 2 "Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"

Data: 18/10/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **EBK SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit me titull: **LOT 2 –"Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-te", ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 23.06.2023, procedurë e hapur, kontrata punë, hapja e ofertave është bërë me datë 07.08.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 19.10.2023.**

OE ankuesi i pa kënaqur me vendimin e AK-së, si dhe me përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, me datë 06.11.2023 parashtron ankesë në OSHP, kundër anulimit të Aktivitetit të prokurimit si dhe kundër eliminimit të të njëjtit.

Fillimisht sqarojmë se, AK në kërkesën për rishqyrtim, OE ankuesit pretendimin e parë ia aprovon si të bazuar dhe si e tillë nuk është e nevojshme ta shqyrtojmë tutje, **për faktin se është pretendim i bazuar.**

Kurse sa i përket pretendimit të dytë të OE ankuesi:

Ne piken e dyte:

Kerkesa 2, Nje teknik i certifikuar per BMS - deshmia certifikata perkatese e noterizuar nga origjinali se paku jo me vjeter se 6 muaj, CV, kontrata ose marreveshja e punes valide per kete projekt. Leter reference nga punedhenesi ose cfaredo dokumenti tjeter qe deshmon per punet dhe pervojen e meparshem ne lemin e kerkuar. AK thekson se OE, per teknikun per BMS me iniciale V.G. nuk ka prezentuar marreveshje valide te punes per kete projekt. AK thekson se

kontrata nuk eshte valide sepse eshte nenshkruar nga nje pale e trete ne emer te teknikut. Ne lidhje me kete pretendim te AK ne e kemi sqaruar ne Kerkesen per Rishqyrtim si vijon "ne periudhen kur eshte dorezuar tenderi, tekniku V.G. ka qene ne udhetim jashte shtetit, ne Gjermani, dhe me autorizim nga vet tekniku, eshte nenshkruar kontrata. Nese tekniku nuk ka qene fizikisht, dhe nese nenshkrimi do te ishte bere ne emer te V.G. atehere ne do te kryenim veper penale te falsifikimit te dokumentit, andaj, ne duke pasur konfirmimin verbal nga V.G. se do te jete ne dipozicion per kete kontrate, dhe me lejen e tij, kemi nenshkruar ne emer te V.G. AK duke aplikuar nenin 72 te LPP mund te kerkoje sqarime, dhe tekniku V.G. eshte i gatshem qofte me prezence fizike, qofte me deklarate te shkruar te konfirmoj se do te jete ne dispozicion te plote per realizimin e puneve te BMS per kete kontrate. Ne zotohemi se inxhinieri B.J. dhe tekniku i BMS V.G. jane ne dijeni te plote te kushteve te kontrates, dhe jane ne pajtim te plote per angazhimin e tyre ne kete procedure prokurimi."

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron, OE ankuesi në ofertë ka bashkangjitur kontratën për personin në fjalë, mirëpo të nënshkruar nga një person tjetër, për të cilin OE deklaron se ka qenë i autorizuar. Në rastin konkret, OE në ofertë nuk posedon autorizim për personin, mirëpo AK konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime se nëse OE posedon autorizimin e noterizuar para datës së hapjes së ofertave.

Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit rekomandoj të kthehet në rivlerësim, duke rekomanduar AK-në që rivlerësimin e ofertave ta zhvilloj konform dipozitave ligjore të LPP-së, udhëzuesit dhe rregullores për prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **EBK SH.P.K.**

Blerina Hurtglica